

Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS

(prill 2020 – mars 2021)

DHE

PLANI I PUNËS

(prill 2021 – mars 2022)

Prishtinë, prill 2021

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË OSK-SË

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të OSK-së,

Kam nderin që të paraqes para juve raportin vjetor të punës për periudhën prill 2020 – mars 2021, që përfshin zhvillimet dhe punën e të gjitha organeve të OSK-së.

Viti 2020 filloi me pandeminë Covid 19 që preku tërë botën, jeta e të gjithëve ka ndryshuar dhe po kështu ka paraqitur shumë kufizime dhe sfida. Megjithatë, krahas kësaj dhe krahas punës dhe angazhimeve nga detyra e të parit të OSK-së, me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur kemi arritur që gjatë kësaj periudhe njëvjeçare të realizojmë me sukses objektivat e parapara.

Prandaj, shfrytëzoj rastin që t'ju falenderoj për angazhimin, mbështetjen dhe përkrahjen të pazezervë dhënë Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Me respekt,

Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës Prof. Dr. Blerim Kamberi

PËRMBAJTJA

<i>Hyrje</i>	3
<i>Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridbënia për punën e organeve të Odës</i>	4
<i>Azhuurnimi në baza mjore i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrit të licencave të stomatologëve</i>	4
<i>Zhvillimi i procedurave për formatin unik të faksimilit</i>	4
<i>Punat e organeve dhe komisioneve të përbershme të Odës</i>	5
<i>Regjistrimi, licencimi dhe rilicencimi i stomatologëve</i>	5
<i>Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)</i>	6
<i>Çështjet etike</i>	8
<i>Komisioni për buxhet dhe financa</i>	9
<i>Solidariteti dhe ndihma reciproke</i>	9
<i>Bashkëpunimi ndërkombëtar</i>	9
<i>Memorandumet e bashkëpunimit</i>	10
<i>Bashkëpunimi me odat tjera të profesionistëve shëndetësor</i>	12
<i>Mbrojtja e interesave profesionale, konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët e Odës</i>	13
<i>Aktivitetet tjera</i>	16
<i>Raporti i pasqyrave financiare</i>	19
<i>Plan veprimi për periudhën prill 2021 – mars 2022</i>	24

HYRJE

Oda e Stomatologëve të Kosovës në përputhje me mandatin e saj ligjor të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutit të OSK-së, si dhe planit vjetor të punës, ka realizuar aktivitetet e planifikuara gjatë periudhës prill 2020 – mars 2021 edhe përkundër shpërthimit të pandemisë COVID-19 në mars të vitit 2020. Raporti në vijim pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara që njëherit kanë qenë të përfshira në planin vjetor të punës së OSK-së.

Në vijim janë paraqitur objektivat dhe veprimet specifike të cilat kanë qenë të planifikuara për periudhën prill 2020 – mars 2021.

- Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënja për punën e Odës,
- Asistenca në zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin e kapacitetit të EVP-së dhe në regjistrimin, licencimin/ilicencimin e stomatologëve,
- Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK,
- Azhurnimi në baza mujore i regjstrit të anëtarësisë dhe regjstrit të licencave të stomatologëve,
- Prgatitjet për procedurat e faksimilit unik për stomatologët e vendit,
- Organizimi i Konferencës vjetore stomatologjike,
- Realizimi i programit të ligjeratave në 7 (shtatë) QKMF në kuadër të EVP-së,
- Mbrojtja e interesave profesionale, konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët e odës,
- Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme vendore dhe rajonale
- Bashkëpunimi me odat tjera të profesionistëve shëndetësor,
- Vazhdimësia e bashkëpunimit me FDI dhe European Regional Organization (ERO),
- Auditimi financiar për vitin 2018 dhe 2019.

1. VAZHDIMËSIA E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIA PËR PUNËN E ORGANEVE TË ODËS

Në vazhdimësi është ngritur transparenca dhe llogaridhënia për punën e të gjitha organeve të OSK-nëpërmjet Web-faqes së Odës si mjet për realizimin e këtij objekti. Janë publikuar të gjitha informatat rreth punës së organeve të Odës, vendime dhe çështje tjera relevante të përditësuara në baza të rregullta, që janë me rëndësi për komunitetin e stomatologëve të vendit, e të cilat do të nxisin në vazhdimësi llogaridhënien dhe transparencën e punës së organeve të Odës.

2. AZHURNIMI NË BAZA MUJORE I REGJISTRIT TË ANËTARËSISË DHE REGJISTRIT TË LICENCAVE TË STOMATOLOGËVE

Në baza mujore është bërë përditësimi i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrit të licencave valide të stomatologëve në nivel vendi në Webfaqen zyrtare të Odës.

Deri në ditën e raportimit të punës sonë njëvjeçare, Oda e Stomatologëve të Kosovës numëron 1836 anëtarë të anëtarësuar në odë dhe 1731 stomatolog me licencë valide të punës.

3. ZHVILLIMI I PROCEDURAVE PËR FORMATIN UNIK TË FAKSIMILIT

OSK ka zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme për furnizim për punimin/ prodhimin e autorizuar të faksimilave sipas formës së miratuar dhe përmbajtjes të përcaktuar me Rregullore për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim të Stomatologëve. Prandaj, të gjithë stomatologët që ofrojnë shërbime shëndetësore-stomatologjike dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, do të jenë të obliguar që të pajisen me faksimilet unike të prodhuara nën autoritetin e OSK-së. Afati kohor për tu pajisur me faksimil do të jetë brenda periudhës prill – qershor 2021, ndërsa pas datës 1 Korrik 2021, të gjithë stomatologët që posedojnë licencë valide do të jenë të obliguar që të jenë të pajisur me faksimilin zyrtar të lëshuar nga OSK-ja.

4. PUNA E ORGANEVE DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË ODËS

Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i OSK-së ka mbajtur tri mbledhje (votim elektronik, me e-mail), 17 korrik 2020; 24-29 dhjetor 2020 dhe 18-19 shkurt 2021 me ç'rast është miratuar raporti vjetor i punës së OSK-së për periudhën 01.04.2019 - 31 mars 2020; Plani i punës së OSK-së për periudhën 01 Prill 2020 – 31 Mars 2021, Projekt-buxheti i OSK-së për vitin 2021 dhe Plotësim/ndryshimi i vendimit nr. 1058 të dt 26.12.2019 për caktimin e lartësisë së taksës administrative, taksa administrative për lëshimin e faksimilit prej 20 € ulet në shumë prej 15€.



Këshilli Drejtues ka mbajtur 10 (dhjetë mbledhje) me ç'rast janë marrë disa vendime të rëndësishme, si, të gjithë anëtarët e OSK-së lirohen nga plotësimi i kriterit të paraparë për pikët kredituese për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së për vitin 2020; miratimi i raportit vjetor i punës së OSK-së për periudhën 01.04.2019 - 31 mars 2020 dhe Plani i punës së OSK-së për periudhën 01 Prill 2020 – 31 Mars 2021; Auditimi financiar për vitet 2018 dhe 2019; miratimi i projekt-buxhetit të OSK-së për vitin 2021; Vendim mbi sjelljen dhe standardet e veshjes së punonjësve në shërbimin profesional.

5. REGJISTRIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI I STOMATOLOGËVE

Komisioni për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të Stomatologëve ka kryer procedurat ligjore të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit të stomatologëve.

Gjatë periudhës 1 Prill 2020 – 31 Mars 2021 janë:

- a. Të anëtarësuar **188** stomatolog,
- b. Të licenuar **158** stomatolog (licencim Doktor i Stomatologjisë) dhe 49 licencim specialistik
- c. Të rilicenuar **66** stomatolog (rilicencim Doktor i Stomatologjisë dhe 28 rilicencim specialistik.
- d. Të ç'antërasuar (në mënyrë të vullnetshme) **3** stomatolog.



6. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Me vendim të Këshilli Drejtues Nr. 1162 të Kosovës në datën 12.06.2020 të gjithë anëtarët e OSK-së lirohen nga plotësimi i kriterit të paraparë për pikët kredituese për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së për vitin 2020 për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KVEP) gjatë kësaj periudhe ka akredituar aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional, si vijon:

- Kompania Dentsply Sirona për Webinarin/ligjeratën ‘‘Pse 3D cbct’’ dhe ‘‘Navigimi Vëllimor Radiologjik në Stomatologji’’, 20 Prill 2020.
- Institutit i Edukimit të lartë, Konferencë ‘‘Konferencë ndërkombëtare e shkencave stomatologjike’’ 30-31 Tetor 2020.
- Oda e Stomatologëve të Kosovës (Konferencë), Konferenca e V-të Stomatologjike – virtuale ‘‘Stomatologjia në rrethanat e pandemisë’’ mars, 2021.

Në periudhen raportuese KEVP ka lëshuar 70 Certifikata/vërtetime mbi valorizimin e pikëve kredituese të anëtarëve të saj si dëshmi se plotësojnë kushtet për rilicencimin e tyre, ndërsa 3 raste janë refuzuar për mungesë të pikëve kredituese jot ë mjaftueshme.

- **Realizimi i programit të ligjeratave në 7 (shtatë) QKMF në kuadër të EVP-së**

Nga programit i ligjeratave për vitin 2020 nëpër Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare është mbajtur vetëm një ligjeratë, sepse pas shpërthimit të pandemisë Covid-19, Qeveria jonë kishte ndërmarr masat anticovid 19 në nivel vendi, të cilat janë të njohura për të gjithë ne.



Pjesëmarrës në ligjeratën e organizuar në QKMF-Mitrovicë

- **Organizimi i Konferencës vjetore stomatologjike**

Oda e Stomatologëve të Kosovës me rastin e shënimit të ditës botërore të Shëndetit Oral ka organizuar Konferencën e V-të Stomatologjike-Virtuale me datë 20 Mars 2021 në Prishtinë. Konferenca ka përfshirë 8 ligjerata me ligjërues vendorë dhe ndërkombëtarë nga SHBA, Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia Veriore. Pjesëmarrja ka qenë mjaft masive.



Pamje nga Konferenca e V-të Stomatologjike -Virtuale, 20 mars 2021

7. ÇËSHTJET ETIKE

Në periudhën raportuese janë shqyrtuar shtatë raste për pretendim të shkeljes etike. Në njërin rast prokurori dhe zv.prokurori i Odës e kanë dërguar lëndën në Këshillin Etik për pretendim të shkeljes etike; rasti i dytë është mbyllur për shkak të vonesës së kompletimit të lëndës nga pala ankuese; në rastin e tretë lënda është mbyllur te prokurori me dakordim të palëve.

Në katër raste, Këshilli Etik ka shqiptuar masat disiplinore: një kërkim falje me shkrim ndaj infermierës, dy qortime me shkrim për shkak të vonesës së anëtarësimit dhe rilicencimit të tyre. Në rastin e katërt, lëndën e prokurorit të shtetit, komisioni etik e ka bartur në komisionin profesional mjekësor. Komisioni, ka hudhur poshtë pretendimet e pacientit për shkelje profesionale.

Këshilli Etik gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 19 vërtetime për të kaluarën etike.

Komisioni Etik në periudhë njëvjeçare, ka shqyrtuar dy raste për leje të hulumtimit bio-mjekësor, me ç'rast njëri rast është aprovuar, ndërsa rasti tjetër është refuzuar për shkak mos përmbushjes së kritereve të parapara për hulumtim bio-mjekësor.

8. KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA

Gjatë kësaj periudhe kohore njëvjeçare, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur tri mbledhjet e punës. Në kuadër të këtyre tri mbledhjeve, nga Komisioni për Buxhet dhe Financa janë analizuar, shqyrtuar si dhe është bërë aprovimi i raporteve financiare dhe i projekt buxhetit të OSK-së, për periudhat si në vijim:

- 1) Raporti financiar 6 mujor për periudhën: 01.10.2019 – 31.03.2020,
- 2) Raporti financiar 6 mujor për periudhën: 01.04.2020 – 30.09.2020, dhe
- 3) Miratimi i projekt buxhetit të OSK-së, për vitin 2021.

9. SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE

Në Komisionin për Solidaritet dhe Ndihme Reciproke gjatë periudhës raportuese nuk është paraqitur asnjë rast për mbështetje financiare për shkaqe shëndetësore.

10. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

- Pjesëmarrja në aktivitetet e FDI

Në cilësinë e zyrtarit të OSK-së për ndërlidhje me Federatën Ndërkombëtare Stomatologjike (FDI), Dr. Kastriot Meqa ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara në mënyrë virtuale nga organet e FDI, për detyrat që u takojnë anëtarëve të rregullt të kësaj organizate. me theks të veçant në informatat mbi COVID-19

- **Vizita e kryetarit dhe nënkryetarit të OSK-së në Fakultetin e Mjekësisë Dentare-Tiranë**

Me dt. 12 Shkurt 2021 në Tiranë është realizuar takimi zyrtar i kryetarit dhe nënkryetarit të OSK-së me dekanen e Fakultetit të Mjekësisë Dentare. Shprehëm vullnetin dhe mirëkuptimin për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të domosdoshëm për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës profesionale të stomatologëve nëpërmjet formave të ndryshme të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional. Poashtu u dakorduam për të shkëmbyer informacione dhe materiale në ato fusha që janë me interes të përbashkët si dhe shkëmbimin e pedagogëve për mbajtjen e ligjeratave në kuadër të aktiviteteve të EVP.

Në këtë takim u nënshkrua edhe Marrëveshja e bashkëpunimit, ku shprehëm vullnetin tonë për bashkëpunim të qëndrueshëm me interes bilateral.



Nga takimi në Fakultetin e Mjekësisë Dentare-Tiranë

11. MEMORANDUMET E BASHKËPUNIMIT

- **Memorandumi me Shoqatën e Stomatologëve të Kosovës**

Me dt. 02.02.2021, është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit me Shoqatën e Stomatologëve të Republikës së Kosovës, ku ndër tjerash kemi shprehur vullnetin dhe mirëkuptimin për bashkëpunim reciprok në fushën e shkëmbimit të informacioneve, përvojave dhe organizimit të përbashkët të aktiviteteve profesionale e shkencore, si ligjërata, kongrese, konferenca, tubime

shkencore, seminare, simpoziume, trajnime dhe forma tjera, me qëllim të mbështetjes së procesit të ngritjes dhe avancimit profesional të stomatologëve në nivel vendi..



Memorandumi me Shoqatën e Stomatologëve të Kosovës

- **Memorandumi me Institutin për hulumtime dhe trajnime në shkencat mjekësore “Rezonanca”**

Me datë 24.02.2021 në ambientet e Kolegjit “Rezonanca” është nënshkruar një marrëveshje e bashkëpunimit me Institutin për hulumtime dhe trajnime në shkencat mjekësore “Rezonanca. Kjo marrëveshje parasheh bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve shkencore në mjekësinë dentare, promovimin e shëndetit oral, konsulencave profesionale, trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional.



12. BASHKËPUNIMI ME ODAT TJERA TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR

- Komunikatë e përbashkët e Odave të e Profesionistëve Shëndetësorë mbi gjendjen e profesionistëve shëndetësorë gjatë pandemisë COVID 19,
- Takimi i OPSH me Ministrin e Shëndetësisë lidhur me punën e odave si dhe çështja e specializimeve,
- Shkresa e përbashkët e OPSH-ve drejtuar Ministrit të Shëndetësisë për bashkërendim lidhur me zbatimin e kompetencave ligjore të Odave të profesionistëve shëndetësor,
- Kërkesë e odave të profesionistëve shëndetësorë drejtuar Zyres së Kryeministrit lidhur me Udhëzimin Administrativ 05/2017 për Shkollimin Specialistik,
- Parashtrimi i kërkesës së përbashkët të OPSH-ve drejtuar Zyres së Kryeministrit të Republikës së Kosovës lidhur me anulimin e Udhëzimit Administrativ 05/2017 për Shkollimin Specialistik, pasi që është konstatuar se ky akt nënligjor çënon autorizimet ligjore të bazuara në Ligjin 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe në Ligjin 04/L-125 për Shëndetësinë,
- Komunikatë e përbashkët e Odave të Profesionistëve Shëndetësor për thirrje institucioneve shëndetësore që në nderim të profesionistëve shëndetësor të cilët humbën jetën nga Covid 19, si dhe në si mbështetje të profesionistëve shëndetësor të cilët vazhdojnë luftën kundër Covid 19 të ndezin qirinjë,
- Odat e Profesionistëve Shëndetësor në bashkë-koordinim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK), si organizata që përfaqësojnë interesat profesionale dhe socio-ekonomike, të profesionistëve shëndetësor të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të përfaqësuesve, të mbajtur me 01 korrik 2020, në nivel të kryetarëve, kanë analizuar njoftimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetueshmërisë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, dhe duke i marrë në konsideratë dhe me shqetësim pozitën, rëndësinë dhe funksionin publik të profesionistëve shëndetësor, ikemi adresuar kërkesat tona të përbashkëta tek Qeveria e Republikës së Kosovës,

- Komunikatë e përbashkët e Odave të profesionistëve shëndetësorë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës. lidhur me vendimin për krijimin e komitetit të përbashkët për analizimin e menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia. Rekomandimet e dala nga ky komitet, së bashku me informatat e përditësuara, do të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë për veprimet dhe hapat e mëtutjeshëm të cilat duhet marrë në menaxhimin e situatës,
- Themelimi Komisionit Ekzekutiv të përbashkët për luftimin, monitorimin dhe reagimin ndaj SarS CoV2 – COVID-19.



Ndezja e qirinjëve në nderim të profesionistëve shëndetësor të cilët humbën jetën nga Covid 19

13. MBROJTJA E INTERESAVE PROFESIONALE, KONSULTA, INFORMACIONE DHE SHËRBIME TË TJERA PËR ANËTARËT E ODËS

- Stomatologët e sektorit publik të përfshihen në listat e kompenzimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Oda e Stomatologëve të Kosovës ka mbështetur shqetësimet e anëtarëve të saj në lidhje me trajtimin diskriminues ndaj tyre për shkak të mosrealizimit të shtesave të pagave gjatë ushtrimit me rrezik të profesionit në përballje me COVID-19.

Me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të anëtarëve të saj, OSK insiston që stomatologët, si pjesë përbërëse e sistemit shëndetësor të Republikës së Kosovës, dhe duke u bazuar në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të trajtohen si kategori me rrezik të drejtëpërdrejtë nga infektimi me shkaktarin e sëmundjes CoViD-19.

- **Propozim për përfshirjen e ambulancave stomatologjike private në planin operacional për pakon fiskale emergjente**

Nëpërmjet postës elektronike me dt.07.04.2020 jemi drejtuar Z. Besnik Bislimi - Ministër i MFT, Znj. Rozeta Hajdari - Ministre e MEPTINIS dhe Dr. Arben Vitia – Ministër i MSH, për përfshirjen e ambulancave stomatologjike private në planin operacional për pakon fiskale emergjente:

- Të sigurohen pagat nga Qeveria për ambulancat stomatologjike në sektorin privat, për të gjitha bizneset, të cilave Ministria e Shëndetësisë me vendimin numër nr.21/III/ 2020 të datës 20/03/2020 ua ka ndërprerë veprimtarinë.
- Qeveria e Republikës së Kosovës të kompensojë shpenzimet e qirasë së objekteve të ambulancave stomatologjike private të cilat janë mbyllur me vendim të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Të paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës tatimi në fitim, për kuartalin e parë (TM1) dhe obligimet tjera tatimore për sektorin privat, derisa të ndryshohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për të filluar puna normale.
- Të zgjatet me automatizëm afati i licencave të operimit, për të gjitha licencat të cilave u ka skaduar afati, deri në marrjen e ndonji vendimi tjetër.

- **Mbështetje për përfshirjen e specialistëve të rinj në financim nga programi për subvencione**

Oda e Stomatologëve të Kosovës do të vazhdojë të japë kontributin e saj për të gjitha zhvillimet për avancimin e pozitës së stomatologut duke u zotuar se do të jetë përkrah kërkesave të tyre

OSK-ja ka shprehur përkrahjen e rezervë të saj për profesionistët e rinj shëndetësor-specializantët që të përfshihen në financim të edukimit specialistik nga programi për subvencione.

Duke u bazuar në detyrat e Odës së Stomatologëve të Kosovës në mbrojtjen dhe promovimin e profesionistëve shëndetësorë, stomatologëve në sektorin publik dhe privat, OSK, i është drejtuar Ministrit të Shëndetësisë në detyrë, Zt. Armend Zemajt, me një kërkesë për mbështetjen financiare të specializantëve nga lëmitë e stomatologjisë të cilët janë me vetëfinancim.

Kjo kërkesë ka hasur në mirëkuptim dhe se janë bërë përgatitjet përfundimtare nga MSH për realizimin e financimit të specializantëve.



Nga takimi me specializantët e stomatologjisë

- **Shkresa drejtuar Minsitrisës së Shëndetësië për përfshirjen e stomatologëve të sektorit privat në programin e vaksinimit kundër Covi19**

Oda e Stomatologëve të Kosovës nëpërmjet një shkrese i është drejtuar Ministrin në detyrë të Shëndetësisë Z. Zemaj për përfshirjen e stomatologëve të sektori privat në programin e vaksinimit kundër COVID 19. Gjithashtu kemi shprehur gadishmërinë e plotë që në çdo kohë t'ju ofrojmë ekspertizën profesionale institucioneve përkatëse, drejt realizimit të këtij procesi së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë.

Pas kësaj kërkesë Ministria e Shëndetësisë ka reflektuar përballë kërkesave tona mbi përfshirjen e stomatologëve të sektorit privat në procesin e vaksinimit nga pandemia COVID 19. Ministria ka kërkuar që të dhënat për stafin mjekësor të sektorit privat t'i dërgojnë të dhënat në adresën: vaksinimi@rks-gov.net.

14. AKTIVITETET TJERA

- Me 2 maj 2020 kemi publikuar dokumentin që jep opinionin e Qendrës Europiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Infektive (ECDC) për përshtatshmërinë e maskave të fytyrës dhe mbulesave të tjera të fytyrës në komunitet nga individë të cilët nuk janë të sëmurë, me qëllim të zvogëlimit të transmetimit të mundshëm para-simptomatik ose asimptomatik të COVID-19 nga mbajtësi i maskës tek të tjerët.

- Me 7 maj 2020, KD i OSK-së i ka propozuar MSH rekomandimet e mëposhtme për miratim:

Ordinancat stomatologjike private të ofrojnë vetëm shërbimet emergjente/urgjente stomatologjike, ndërsa shërbimet tjera të shtyhen për disa javë të ardhshme, deri në njoftimin e ardhshëm;
Udhëzimet praktike për profesionalistët e stomatologjisë në sektorin privat kundër Covid-19;
Formular i pëlqimit për trajtimin e emergjencave/urgjencave stomatologjike;
Shërbimet e lejuara stomatologjike në sektorin privat gjatë pandemisë covid-19

- Takimi i përbashkët me Kryeministrin Hoti, Ministrin e Shëndetësisë Zemaj dhe me Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, të mbajtur me 10 Qershor 2020. Temë qendrore e takimit ishte roli i profesionistëve shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19. Gjatë takimit Kryeministri Hoti premtoi mbështetje të mëtutjeshme dhe koordinim të ngushtë me odat përkatëse për të mënjanuar mundësinë e përhapjes së një vale të dytë të virusit.

- Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, me 22 qershor është themeluar Komisioni Ekzekutiv për luftimin, monitorimin dhe reagimin ndaj SarS CoV2 – COVID-19, që ka për qëllim të shqyrtojë dhe informojë Qeverinë për çështje të caktuara në lidhje me SarS CoV2 – COVID-19 dhe të këshillojë dhe t'i propozojë Qeverisë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për luftimin dhe përballje me SarS CoV2 – COVID-19. Në këtë komision është caktuar si anëtar edhe kryetari i OSK-së.

- Oda e Stomatologëve të Kosovës ka kërkuar nga Qeveria që t'i përfshijë stomatologët e sektorit publik, në pakon për pagesën e 300 eurove shtesë mbi pagat gjatë pandemisë.
- Njoftimet më reja nga organizatat ndërkombëtare (FDI, ICD etj) lidhur me të dhënat mbi COVID 19
- Shkresa Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës për planifikim të numrit të studenteve të stomatologjisë që pranohen në UP dhe Kolegjet private të arsimit të lartë.
- Pjesëmarrja e perfaqësuesit të OSK-së në komisionin për hartimin e projekt-ligjit për sigurime shëndetësore.
- Takimi i Kryetarit të OSK-së me zv. Ministrin e Shëndetësisë Dr. Luan Gola Në këtë takim janë shprehur shqetësimet tona në disa fusha me rëndësi, si, plotësimi i UA 8/2017 në të cilin duhet të parashihet si staf në kuadër të nivelit parësorë edhe specialistët e stomatologjisë, bartja e kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësi dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësorë në Odat e Profesionistëve Shëndetësor me theks të veçantë të kompetencat në fushën e edukimit specialistik dhe atë të licencimit, angazhimi i numrit të vogël të stomatologëve në sektorin publik dhe problematika tjera.



Takimi i kryetarit të OSK-së me Zv. Ministrin e Shëndetësisë

- Raportimi i monitorimit dhe vlerësimit të indikatorëve 3.2 dhe 3.2.3 Oda e Stomatologëve të Kosovës në baza vjetore raporton indikatorët e përcaktuar në bazë të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë (2017-2021) pranë Divizionit për Monitorim dhe Vlerësim në Ministrinë e Shëndetësisë. Të dhënat e krahasuara të këtyre indikatorëve paraqiten me vlerën të ndryshme me 73% në vitin 2018, me 93% në vitin 2019 dhe 94.5% në vitin 2020.. Bazuar në matricën e SSSH-së 2017-2021, vlera prej 94.5 % në vitin 2020 na paraqitet në pragun e performancës së dëshirueshme. Sipas trendit mund të themi se vlera finale në fund të implementimit të SSSH-së në vitin 2021 mund të jetë në mbi 93.3 % e që do të paraqet një performancë shumë të kënaqshme.

15. RAPORTI I PASQYRAVE FINANCIARE

Tabelat me poshtë paraqesin pasqyrimin e të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të Odës, për periudhën 01 prill 2020 – 31.mars 2021. Në kategorinë e të hyrave (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) gjithsejt kanë qenë 86,379.11€, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) janë shpenzuar gjithsejt 69,979.48 €.

Sipas planit të paraparë është bërë auditimi i jashtëm financiar i OSK-së për vitin fiskal 2018 dhe 2019.

Sipas opinionit të auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2018 janë konstatuar disa mangësi në përgatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare dhe mbajtjen e librave kontabel si ditari, libri kryesor, librat ndihmës të cilat janë bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare, e që në vitin 2018 nuk janë arritur të përmbushen kërkesat e standardeve dhe ato ligjore.

Ndërsa për pasqyrat financiare per vitin 2019 sipas auditorit, paraqiten drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Odës dhe rezultatin e saj financiar si dhe rrjedhën e parasë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

RAPORT I PËRGJITHSHËM FINANCIAR
PERIUDHA RAPORTUESE: 01.04.2020 – 31.03.2021

I. TË HYRAT:

1 - NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1-TM4
1.1.	Të hyrat nga anëtarësimi	2,300.00€	23,200.00€	6,900.00€	7,800.00€	40,200.00€
1.2.	Të hyrat nga licencimi/rilicencimi	3,000.00€	10,840.00€	6,360.00€	7,560.00€	27,760.00€
1.3.	Të hyrat nga konferenca	-	-	-	8,975.10€	8,975.10€
1.4.	Të hyrat nga EVP	-	-	300.00€	262.00€	562.00€
1.5.	Të hyrat nga Kodi Etik	120.00€	150.00€	240.00€	60.00€	570.00€
1.6.	Të hyrat nga vërtetimet e anëtarësisë në OSK	-	2,025.00€	50.00€	335.00€	2,410.00€
1.7.	Të hyrat nga taksa për regjistrim dhe valorizim	140.00€	585.00€	270.00€	330.00€	1,325.00€
1.8.	Të hyrat nga mbajtja e provimeve vlerësuese dhe shqiptimi i masave disiplinore	-	1,200.00€	600.00€	1,100.00€	2,900.00€
1.9.	Të hyrat tjera (duplikim i Licencës, ndërrim i ID, kthime)	-	15.00€	85.00€	271.50€	371.50€
GJITHSEJ						85,073.60€

2 - NË NËNLLOGARINË BANKARE TË FONDIT PËR SOLIDARITET

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1:TM4
1.1.	Të hyrat nga pagesat e gjobave për Ri-Licencim	195.00€	150.00€	305.00€	425.00€	1,075.00€
1.2.	Donacion-mëditjet nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa të OSK-së	-	130.51€	-	-	130.51€

1.3.	E hyrë nga pagesa për Licencim (deponimi gabim)	-	-	100.00€	-	100.00€
GJITHSEJ						1,305.51€

Total i të hyrave: Llogaria kryesore + Llogaria e Solidaritetit (1+2)	86,379.11€
---	-------------------

II. SHPENZIMET:

1 - SHPENZIMET NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIMET TM1-TM4
2.1.	Shpenzimet për paga dhe mëditje	10,113.54€	11,848.45€	11,618.26€	12,140.38€	45,720.63€
2.2.	Tatimet për paga dhe mëditje	901.74€	1,094.65€	1,065.88€	1,099.10€	4,161.37€
2.3.	Kontribute pensionale	1,159.50€	1,354.50€	1,314.50€	1,338.50€	5,167.00€
2.4.	Konferenca e OSK-së	-	-	-	4,010.31€	4,010.31€
2.5.	Auditimi i jashtëm financiar i OSK	-	-	4,200.00€	0€	4,200.00€
2.6.	Pajsje dhe inventar	-	596.64€	-	25.98€	622.62€
2.7.	Anëtarësimi në FDI	484.88€	-	-	-	484.88€
2.8.	Printimi i ID kartelave të anëtarëve	590.00€	85.00€	24.50€	0€	699.50€
2.9.	Administrative/Operacionale të zyrës: materiale pune për zyrë	198.92€	475.68€	458.83€	403.27€	1,536.70€
3.0.	Reprezentacion për KD dhe komisione të përherëshme, telefon dhe internet, derivate, taxi)	326.79€	407.13€	437.31€	682.34€	1,853.57€
3.1.	Provizione bankare dhe kthime tjera	80.20€	195.40€	227.20€	908.10€	1,410.90€
GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë kryesore të OSK-së						69,867.48€

2 - SHPENZIMET NË LLOGARINË E FONDIT PËR SOLIDARITET

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIM ET TM1:TM4
2.1.	Transfer në llogarinë kryesore i pagesës për Licencim	-	-	100.00€	-	100.00€
2.2.	Provizione bankare	3.00€	3.00€	3.00€	3.00€	12.00€
GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë e Solidaritetit të OSK-së						112.00€

Total i Shpenzimeve: Llogaria kryesore + llogaria e Solidaritetit (1+2)	69,979.48 €
--	--------------------

1 – Llogaria kryesore bankare e OSK-së	2- Nënllogaria e Fondit për Solidaritet
<u>SALDO ME DATË 01.04.2020</u> 60,180.76€	<u>SALDO ME DATË: 01.04.2020</u> 3,296.60€
GJITHSEJ TË HYRAT..... 85,073.60€	GJITHSEJ TË HYRAT 1,305.51€
GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....145,254.36€	GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....4,602.11€
GJITHSEJ SHPENZIMET.....(69,867.48€)	GJITHSEJ SHPENZIMET.....(112.00€)
<u>SALDO ME DATË 31.03.2021</u> 75,386.88€	<u>SALDO ME DATË:31.03.2021</u> 4,490.11€
1-Gjithsej të hyrat..... 85,073.60€	1-Gjithsej të hyrat..... 1,305.51€
2-Gjithsej Shpenzimet.....(69,867.48€)	2-Gjithsej Shpenzimet.....(112.00€)
3-Bilanc pozitiv financiar.....15,206.12€	3-Bilanc pozitiv financiar.....1,193.51€

**RAPORTI NË MES TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR DY LLOGARITË
BANKARE PËR PERIUDHËN: 01.04.2020 – 31.03.2021:**

1 - Të Hyrat gjithsej (1 + 1).....	86,379.11€
2 - Shpenzimet gjithsej (2 + 2)	(69,979.48€)
3 – Bilanc pozitiv financiar (3 + 3).....	<u>16,399.63€</u>

PLAN VEPRIMI I PUNËS PËR PERIUdhËN

prill 2021 – mars 2022

Ky plan është përpiluar në bazë të objektivave të përcaktuara nga Kryetari dhe Këshilli Drejtues dhe të bazuara në programin për vitet 2019-2023.

Në këtë plan janë specifikuar aktivitetet kryesore:

1. Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënja për punën e Odës,
2. Vazhdimësia e publikimit dhe azhurimit të listës zyrtare të anëtarësisë,
3. Vazhdimësia e publikimit të Regjistrit të licencave të stomatologëve,
4. Analizimi i akteve juridike të OSK-së mbi nevojën e plotësim ndryshimit të tyre,
5. Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK,
6. Lëshimi i faksimilave unik për stomatologët e licencuar,
7. Organizimi i Konferencës vjetore stomatologjike,
8. Realizimi i programit të ligjeratave në 7 (shtatë) QKMF në kuadër të EVP-së,
9. Nxjerrja e revistës profesionale,
10. Mbështetja e vazhdueshme ndaj anëtarëve të saj në të gjitha zhvillimet për avancimin e pozitës së stomatologut dhe prezantimit të interesave të tyre profesionale,
11. Organizimi i sondazheve dhe aktiviteteve hulumtuese me qëllim të identifikimit të problemeve, shqetësimeve të komunitetit të stomatologëve si dhe ngritjes së nivelit të tyre profesional,
12. Mbështetja financiare për anëtarët e Odës në rastet e sëmundjeve të rënda nga fondi i veçantë i solidaritetit dhe ndihmës reciproke,
13. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme vendore,
14. Bashkëpunimi ndërkombëtarë dhe rajonal,
15. Vazhdimësia e bashkëpunimit me FDI dhe European Regional Organization (ERO)
16. Auditimi financiar për vitin 2020.